



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2411 Prot.

Roskovec, më 02, 06 2020

VENDIM

Nr. 34 datë 29/05 /2020

**“PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “PËRMIRËSIMI I  
FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM PËR QYTETIN E ROSKOVECIT”**

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika 1.2 gërma b; të Ligjit Nr.8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” nenet 7,8 gërma ç,9/1,10 pika 1 gërma c,11,17 dhe 19; VKM-së nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik “ i ndryshuar; VKM Nr.89 datë 03.02.2016 “Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

1. Shpronësimin e pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga zbatimi i projektit : “Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit” sipas listës bashkëngjitur.
2. Miratimin e vlerës së Shpronësimit të pasurive të sipërcituara me vlerë paraprake si më poshtë :
  - **Vlera e tokës arë : 923208 lekë**
  - **Vlera e kulturës bujqësore : 40984 lekë**
  - **Totali : 964 192 lekë**
3. Fondi për këtë qëllim do të përballohet nga fondi i caktuar në zërin “Shpronësime për interes publik” i planifikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2020.
4. Ngarkohet Komisioni i Shpronësimit me zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Kadri Hyska**

